Dalës-Izlazna
Nr-Br. I - 97 Data Datum 21.07.2021

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq–Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

# EKSTRAKT IPROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.22.06.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin**: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, Qendresa Dubova, Linda Sadiku dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë**: Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH-së, dhepërf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

**1. Arsyetimi për mungesë**
**2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
**3.Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)-i, 2022-2024**
**4. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit**
**5. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, sipas vendimit nr.-I-31, të dt.26.02.2021**
**6. Shqyrtimi i kërkesave**
**7. Të ndryshme**

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.
Miratohet njëzëri trendi i ditës i cekur më lartë.

**Pika e 1 e renditteditës**
Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

**Pika e 2 e rendit të ditës**
Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

**Pika e 3 e rendit të ditës**
**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)-in, 2022-2024.

**Zarife Behluli** – Si grand i përgjithshëm është administrata e përgjithshme, që është 2,361,676 €, grandi specifik i Arsimit është 2,593,44 €, grandi specifik për shëndetësi është 807,703 €, që në total janë 5,762,423 €. Sipas Ligjit të Obiliqit, i kemi 5 milion €, për 3 vite. Të hyrat vetanake për vitin 2022, janë 908,730 €, që në total grandi, ligji dhe të hyrat vetanake janë 3 milion 671,152 €. Tani, këtë e kemi zbërthye në 5 kategoritë ekonomike: paga janë 4,350,000 €, mallra dhe shërbime 1,037,662 €, dhe kjo është vlerë e pandryshueshme në bazë të vitit 2020 dhe ashtu shkruan në Qarkore që nuk ka ndryshim. Shpenzime komunale janë 316,675 €, subvencione 850,000 €, dhe investimet kapitale janë 5,116,816 €. Totali është 11,671,153 €.

**Kryesuesi** – Drejtoria për ekonomi dhe financa me Ekzekutivin, ka mbajtë debatin publik të premten e kaluar. Po ashtu, edhe Komiteti për Politikë dhe Financa dje ka organizue një takim publik lidhur me KAB-in.

**Hysni Mjeku -** Kam një vërejtje pse drejtorët nuk marrin pjesë në mbledhje, përveç drejtoreshës së financave sepse më intereson projektet deri ku kanë shkue.Unë e di se Kryetari është i zënë, por Ekzekutivi duhet të marrë pjesë në mbledhje.

**Kryesuesi** – Ju keni të drejtë, por në muajin e ardhshëm vjen raporti 6 mujor dhe pastaj mund të debatojmë. Tani, unë do ti bëjë disa pyetje dhe drejtoresha le ti evidenton, në mënyrë që të inkorporohen edhe në buxhet.

Te investimet kapitale për vitin 2022, te administrata e përgjithshme, te kërkesat a është paraparë ndonjë billboard elektronik për njoftime elektronike në qytet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, pse jo edhe nëpër fshatra të vendosen tabelat e tilla për njoftime. Te investimet kapitale, askund nuk e pashë një projekt që DSHPE-ja, duhet të na njoftoj për mirëmbajtjen e shenjave të rrugëve në komunikacion. Sa i përket kanalizimit, ne kishim një kërkesë në fshatin Breznicë, lagjja e Koskovikëve, që është e vetmja lagje e cila nuk ka kanalizim dhe vlera e investimit të tij është shumë e madhe. Te kogjenerimi janë dhënë 2 milion €, por qysh është paraparë në vitin 2023 dhe 2024. Është emergjente mirëmbajtja e lumenjëve, sidomos lumi Drenica, për të cilin duhet të ndahen mjete, të trajtohet dhe të zgjidhet ky problem. Mendoj se në Kuvend duhet të sjellet edhe lista specifike e projekteve. Te rregullimi i parqeve, kanë mbetë edhe 2 parqe papërfundue, një park është në Grabofc dhe një në Dardhishtë, por është edhe Breznica mbi ambullantë atje, ku do të ndërtohet një park.
**Zarife Behluli** - Në Qarkoren e dytë buxhetore, këto ndryshime duhet të inkorporohen.
**Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dheFinanca, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)-i, 2022-2024.**
**Pika 4 e rendit të ditës**
**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën e DKA-së, për themelimin e Komisionit për zgjedhjen e 4 drejtorëve, prej tyre 3 në SHFMU dhe 1 në institucionin parashkollor me këtë përbërje: Fatme Pllana Kryetare, Shyhrete Gashi, anëtare, ndërsa anëtari i tretë do të caktohet nga MASHI.
**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e DKA-së, për themelimin e Komisionit me këtë përbërje: Fatme Pllana Kryetare, Shyhrete Gashi, anëtare, ndërsa anëtari i tretë do të caktohet nga MASHI.**
**Pika 5 e rendit të ditës**
**Kryesuesi** – Paraqiti raportin e DKA-së, sipas vendimit nr.-I-31, të dt.26.02.2021.
**Hysni Mjeku** – Unë kam vërejtje në zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve sepse mungon gjinia femërore.
**Kryesuesi** – Unë inkurajoj që gjinia femërore të marrë pjesë sa më shumë në institucionet publike dhe mund të them se në administratë veç e kemi tejkalue barazinë gjinore, në Arsim gjinia mashkullore ka mbetë pakicë dhe në shëndetësi është e njejta procedurë.
**Pika 6 e rendit të ditës**
**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën nga Ismet Bërbatovci për ndihmë emergjente në vlerën prej 3,000 €.
Kjo kërkesë i rekomandohet për shqyrtim Zyres së Kryetarit dhe DSHPE-së.
**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën nga familja e Ismet Bunjakut për emërim të një rruge në Obiliq. Po ashtu, kemi edhe kërkesën tjetër nga Zeka Mehmeti, për emërim të rrugës, prandaj propozoj që të formohet një Komision në Kuvend për shqyrtimin e kërkesave për emërim të rrugëve.
**Hysni Mjeku** – Unë jam pro formimit të Komisionit, por mendoj se në Obiliq dhe në lagjen Hadja e Re, duhet të bisedohet mirë me banorët në mënyrë të thukët dhe të merret edhe mendimi i tyre për emërimin e rrugëve. Unë jam pro emërimit të rrugëve, por po nisem nga vetëvetja, kam pasë probleme me një familjar shumë të afërt aty, prandaj duhet pasë kujdes sepse është çështje e ndijshme.
**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me 2 shkresa:
1.Nga MPL, për shfuqizim të vendimit nr.-I-70, të dt.30.04.2021, për dhënien e lejes ndërtimore për ndërtimin e garazhdave dhe podrumeve, në lagjen Hadja e Re, në Shkabaj.
2. Nga Ministria e financave e kemi shkresën për shfuqizimin e vendimit nr.-I-68, të dt.30.04.2021, për shujtë të punëtorëve në administratën komunale.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:10'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

**Azize Zeneli**

**Kryesuesi i KPF**

**Burim Gërguri**

REPUBLIKA E KOSOVËS ... KUVENDI KOMUNAL ...
DREJTORIA E ADMINISTRATËS ...
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazna
Nr- Br. I-97 Data Datum 21·07·2021
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq–Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## IZVOD IZ ZAPISNIKA

Sa sastanka Komiteta za politiku i finansije, održanog 22.06.2021, u 10:00, u sali Skupštine opštine.
**Prisustvovali su**: Burim Gerguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, Qendresa Dubova, Linda Sadiku i Slaviša Spasić
**Ostali učesnici:** Zarife Behluli, direktor DPFR i IZHL.
Sastankom je predsedavao Burim Gerguri, predsedavajući koji je nakon što je utvrdio da postoji kvorum započeo sastanak ovim:

## DNEVNIM REDOM

1. **Obrazloženje za odsustvo**
2. **Usvajanje izvoda iz zapisnika sa prethodnog sastanka**
3. **Pregled nacrta srednjoročnog budžetskog okvira za period 2022-2024**
4. **Razmatranje zahteva Direkcije za obrazovanje za uspostavljanje Komisije**
5. **Razmatranje izveštaja Direkcije za obrazovanje, prema odluci br-I-31, od 26.02.2021**
6. **Razmatranje zahteva**
7. **Razno**

**Presedavajući -** Obavestio učesnike o dnevnom redu.
Gore pomenuti dnevni red jednoglasno je usvojen.
**Prva tačka dnevnog reda**
Svi članovi Komiteta su bili prisutni.
**Druga tačka dnevnog reda**
Izvod iz zapisnika sa prethodnog sastanka odobrava se jednoglasno, bez primedbi.
**Treća tačka dnevnog reda**
**Presedavajući** – Podnosi zahtev DPFR za nacrt srednjoročnog okvira budžeta za period 2022-2024.
**Zarife Behluli** – Generalni grant opšte uprave, iznosi 2 miliona 361.676 evra, specifični grant za obrazovanje je 2 miliona 593,44, specifični grant za zdravstvo je 807.703, što ukupno iznosi 5 miliona 762.423 evra. Prema Zakonu Obilića, imamo 5 miliona evra, na 3 godine. Sopstveni prihodi za 2022. godinu iznose 908.730 evra, što ukupan prihod od granta, zakona i sopstvenih izvora iznosi 3 miliona 671.152 evra. Sada smo ovo raspodelili na 5 ekonomskih kategorija: plate su 4.350,000 robe i usluge 1.037.662. Opštinski izdaci su 316.675 evra, subvencije 850.000 evra, a kapitalne investicije 5 miliona 116.816 evra. Ukupan budzet je 11.671.153 evra.
**Presedavajući** – Uprava za ekonomiju i finansije sa izvršnom vlašću održala je javnu raspravu prošlog petka. Takođe, Komitet za politiku i finansije juče je organizovao javni sastanak u vezi sa srednjorocnim okvirom budzeta.
**Hysni Mjeku -** Imam primedbu zašto direktori ne prisustvuju sastanku, osim direktora finansija, jer me zanima dokle su stigli projekti. Znam da je predsednik zauzet, ali izvršni direktori treba da prisustvuje sastanku.
**Presedavajući** – U pravu si, ali sledećeg meseca dolazi šestomesečni izveštaj i onda možemo da raspravljamo. Sad ću postaviti nekoliko pitanja direktorici da bi uvrstila u budžet.

**Zarife Behluli**-U kapitalnim investicijama za 2022. godinu, u opštoj upravi, u zahtevima, postoji li neki elektronski pano za elektronske objave u gradu na albanskom, srpskom i engleskom jeziku, zašto ne i u selima da postave takve oglasne table. Nigde u kapitalnim ulaganjima nisam video projekat koji bi DJS trebalo da nas obavesti o održavanju putnih znakova Što se tiče kanalizacije, imali smo zahtev u selu Breznica, naselje Koskovik, kao jedino naselje koja nema kanalizaciju, a vrednost njegove investicije je veoma velika. Takođe, održavanje reka je hitno, posebno reka Drenica za koju treba izdvojiti sredstva Mislim da bi konkretnu listu projekata trebalo izneti u Skupštinu. od parkova su ostala 2 nedovršena parka, jedan park je u Grabovcu i jedan u Krusevcu ali i Breznici.
**Zarife Behluli** - U drugu budžetsku okružnicu ove promene treba uneti.
**Nakon rasprave, članovi Komiteta za politiku i finansije jednoglasno su preporučili Skupštini opštine na razmatranje i odobravanje Nacrt srednjoročnog budžetskog okvira za period 2022-2024.**
**Četvrta tačka dnevnog reda**
**Presedavajući** – Podnosi zahtev Direkcije obrazovanja za uspostavljanje komisije za izbor 4 direktora, od kojih 3 u osnovnim skolama i 1 u predškolskoj ustanovi u ovom sastavu: predsednik Fatme Pllana, Shyhrete Gashi, član, dok će treći član biti imenovan od strane Ministarstva obrazovanja.
**Članovi Komiteta za politiku i finansije jednoglasno su preporučili Skupštini opštine na razmatranje i odobravanje zahtev DO za uspostavljanje Komisije u sledećem sastavu: Fatme Pllana,Shyhrete Gashi, dok će treći član biti imenovan od strane MO.**
**Peta tačka dnevnog reda**
**Presedavajući** – Iznosi izvetsaj Direkcije obrazovanja prema odluci br.I-31, të dt.26.02.2021.
**Hysni Mjeku** – Imam primedbe na izbor direktora i zamenika direktora, jer nedostaje ženski pol
**Presedavajući** – Ohrabrujem žene da što više učestvuju u javnim institucijama i mogu da kažem da smo u administraciji već premašili rodnu kvotu ravnopravnost, u obrazovanju je muški rod ostao manjina i u zdravstvu je isto.
**Šesta tačka dnevnog reda**
**Presedavajući** – Podnosi zahtev Ismeta Berbatovcija za pomoć u iznosu od 3.000 evra.
Ovaj zahtev se preporučuje za razmatranje kancelariji gradonačelnika i DJS.
**Presedavajući** – Podnosi zahtev porodice Ismeta Bunjaku za imenovanje ulice u Obiliću. Takođe, imamo i drugi zahtev Zeke Mehmeti za imenovanje ulice, zato predlažem da se formira Komisija.
**Hysni Mjeku** – Zalažem se za formiranje Komisije, ali mislim da treba dobro razgovarati sa stanovnicima i takođe dobiti njihovo mišljenje o imenovanju ulica.
**Presedavajući** – upoznao prisutne sa dva dopisa:
1. Za ukidanje odluke br. I-70 od 30.04.2021, za izdavanje građevinske dozvole za izgradnju garaža i podruma, u naselju Novo Hade, u Orlovicu..
2. Za ukidanje odluke Ministarstva finansija br. I-68 od 30.04.2021, za topli obrok radnika u opštinskoj upravi.

**Sastanak je završen u 11:10' časova.**

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E OBILIQIT OBILIQ OPŠTINA REPUBLIKA KOSOVO

**Zapisničar**

______________

**Azize Zeneli**

**Presedavajući KPF**

______________

**Burim Gërguri**